<p>kundrejt një çmimi të caktuar në kontratë dhe me përfundimin e afatit të kontratës, qiramarrësi mund ta blejë pasurinë, të vazhdojë ta mbajë me qira për një afat tjetër ose t'ia kthejë atë qiradhënësit.</p> <p>3. Palët në lizing financiar janë: qiradhënësi dhe qiramarrësi.</p> <p>4. Qiradhënësi kur lejohet të kryejë veprimtari të lizingut financiar, sipas kërkesave të legjislacionit të fushës, do të zbatojë rregullat siç përcaktohen në vijim:</p> <p>4.1. Qiradhënësi, përmes kontratës së qirasë financiare, i jep me qira financiare pasurinë qiramarrësit. Sipas kësaj kontrate përcaktohet afati i përdorimit të pasurisë, përkundrejt pagesave periodike, shuma e të cilave është sa vlera reale në treg e pasurisë, por që mbulon investimin e qiradhënësit dhe siguron një fitim mbi investimin;</p> <p>4.2. Në përputhje me afatin e përcaktuar të qirasë financiare, qiradhënësi i dorëzon mallin qiramarrësit dhe për çdo periudhë mujore i faturon qiramarrësit pagesat e qirasë. Pagesat e qirasë ashtu siç përcaktohet në legjislacionin e fushës janë pagesat periodike, që bën qiramarrësi gjatë afatit të kontratës së qirasë financiare, sipas kushteve të përcaktuara në të;</p>	<p>and once the contract has been terminated, the lessee may purchase the property, continue to hold the lease for another term or return it to the lessor.</p> <p>3. Parties to a financial leasing are; the lessor and the lessee.</p> <p>4. When allowed to conduct financial leasing activities, as required by the field legislation, the lessor shall apply the rules as defined in the following:</p> <p>4.1. The lessor leases the property to the lessor through a financial leasing contract. This contract shall specify the period of use of property, against periodic payments, the amount of which is as much as the property's real market value, but covers the lessor's investment and ensures the return on investment;</p> <p>4.2. Based on the defined term of the financial leasing, the lessor delivers the goods to the lessee and shall invoice the monthly lease payments to the lessee. Lease payments as defined in the related legislation are periodic payments made by the lessee during the term of the leasing contract and under the conditions specified therein;</p>	<p>može kupiti imovinu, da nastavi njegovo korišćenje kao zakup za drugi period ili da ga vrati zakupodavcu.</p> <p>3. Stranke u finansijskom lizingu su: zakupodavalac i zakupac.</p> <p>4. Zakupodavalac kada se dozvoljava da obavlja delatnost finansijskog lizinga, primeniće pravila kao što se određuju u nastavku:</p> <p>4.1. Zakupodavalac, kroz ugovor o finansijskom lizingu, daje pod finansijski zakup imovinu zakupcu. Na osnovu ovog ugovora određuje se rok upotrebe imovine, naspram periodičnih isplata, čiji iznos je na osnovu tržišne vrednosti imovine, ali koji pokriva investiciju zakupodavca i obezbeđuje dobit nad investicijom;</p> <p>4.2. U skladu sa određenim rokom finansijskog zakupa, zakupodavalac dostavlja robu zakupcu i za svaki poreski prihod fakturiše zakupcu isplatu zakupa. Isplate zakupa kao što se određuje zakonodavstvom područja su periodične isplate, koje zakupac isplaćuje tokom vremena trajanja ugovora finansijskog zakupa, na osnovu uslova određenim na njemu;</p>
--	--	--

<p>4.3. Në fund të periudhës së kontratës, nëse qiramarrësi do të ushtrojë mundësinë e blerjes së mallit të përcaktuar në të, qiradhënësi lëshon për të një faturë përfundimtare për vlerën shtesë që duhet të paguajë siç është përcaktuar në kontratë nëse ushtron të drejtën e blerjes së mallit;</p> <p>4.4. Procedurë e njëjtë, sipas përshkimit të mësipërm, kryhet edhe në rastin kur qiradhënësi e prodhon vetë mallin, por roli i furnizuesit përjashtohet nga skema.</p> <p>5. Faturat e blerjes dhe shitjes përkatësisht regjistrohen në librin e blerjes dhe shitjes.</p> <p>6. Lizingu financiar duhet të plotësojë së paku njërin nga katër kushtet, si në vijim:</p> <p>6.1. Afati i lizingut të jetë më i gjatë se shtatëdhjetë e pesë për qind (75%) të jetës së përdorimit të asetit të dhënë me lizing;</p> <p>6.2. Të ketë transferim të pronësisë së asetit të dhënë me lizing te lizingmarrësi në fund të afatit të lizingut;</p> <p>6.3. Të ekzistoj mundësia për të blerë asetin e dhënë me lizing me një “çmim të pranuar” në fund të afatit të lizingut, ose</p>	<p>4.3. At the end of the contract duration, if the lessee will exercise the option of buying the property it is willing to, the lessor shall issue a final invoice for the additional amount to be paid as provided in the contract;</p> <p>4.4. The same procedure as described above is performed when the lessor produces its own good, but the supplier's role is excluded from the scheme.</p> <p>5. Purchase and sales invoices or recorded in the book of purchase and sale.</p> <p>6. Financial Leasing must meet at least one of the four following conditions:</p> <p>6.1. The leasing term longer than seventy-five per cent (75%) of the useful life of the leased property;</p> <p>6.2. Transfer of ownership of the leased property to the lessee at the end of the lease term;</p> <p>6.3. There is the possibility to buy the leased property at a "reasonable price" at the end of the lease term, or</p>	<p>4.3. Na kraju perioda ugovora, ukoliko zakupac koristi pravo kupovine robe određenom na ugovoru, zakupodavalac izdaje jedan završni račun za dodatnu vrednost koja se treba isplatiti kao što je određeno u ugovoru ako koristi pravo na kupovinu robe;</p> <p>4.4. Ista procedura, na osnovu gornjeg opisa, se obavlja u slučaju kada zakupodavalac sam proizvodi robu, ali uloga snabdevača se izuzima od šeme.</p> <p>5. Računi kupovine i prodaje se registruju na knjizi kupovine i prodaje.</p> <p>6. Finansijski lizing treba da ispuni najmanje jedan od četiri uslova, kao u nastavku:</p> <p>6.1. Trajanje lizinga da bude duže od sedamdeset i pet odsto (75%) životnog veka imovine datom pod lizing;</p> <p>6.2. Da bude prenos vlasništva imovine datom pod lizing završetkom trajanja lizinga;</p> <p>6.3. Da postoji mogućnost kupovine imovine datom pod lizing sa “prihvatljivom cenom” završetkom trajanja lizinga, ili</p>
--	---	---

<p>6.4. Vlera aktuale e pagesës së lizingut, e zbritur me një normë të përshtatshme të zbritjes, e tejkalon nëntëdhjetë për qind (90%) të vlerës së drejtë të tregut të asetit.</p> <p>7. Për qëllime tatimore, lizingu financiar konsiderohet, si:</p> <p>7.1. Shitje progresive e asetit të dhënë me lizing me komponentin e kryegjësë së pagesës së lizingut e cila është e tatueshme për lizingdhënësin;</p> <p>7.2. Blerje e asetit të dhënë me lizing në fillim të lizingut, lizingmarrësi ka të drejtën e njohjes së shpenzimeve të zhvlerësimit në lidhje me asetin e pranuar me lizing;</p> <p>7.3. Kredi nga lizingdhënësi për lizingmarrësin, me komponentin e interesit të pagesës së lizingut, që është e hyrë për lizingdhënësin dhe shpenzim për lizingmarrësin. Nga lizingmarrësi, nuk kërkohet që të mbahet tatimi në burim në interes, kur lizingdhënësi është institucion financiar i autorizuar nga Banka Qendrore e Kosovës.</p> <p>8. Lizingu operativ në përmbajtje është marrëveshje e dhënies me qira të asetit. Pagesat e lizingut janë të ardhura të</p>	<p>6.4. The present value of the lease payments, discounted at an appropriate discount rate, exceeds ninety per cent (90%) of the fair market value of the property.</p> <p>7. For tax purposes, financial leasing shall be considered as:</p> <p>7.1. Progressive sale of the leased property with the principal component of the lease payment that is taxable to the lessor;</p> <p>7.2. Purchase of the leased property at the beginning of the leasing, the lessee has the right to recognise the depreciation expense related to the leased property;</p> <p>7.3. Loans from the lessor to the lessee, with the interest component of the lease payment, which is income for the lessor and an expense for the lessee. The lessee is not required to withhold tax on interest when the lessor is a financial institution authorized by the Central Bank of Kosovo.</p> <p>8. Operational lease is the property leasing agreement. Lease payments are taxable income to the lessor and deductible</p>	<p>6.4. Sadašnja vrednost isplate lizinga, umanjena za prikladnom stopom popusta, premašuje devedeset odsto (90%) pravične tržišne vrednosti.</p> <p>7. U poreske svrhe, finansijski lizing se smatra kao:</p> <p>7.1. Progresivna prodaja imovine datom pod lizing sa komponentom glavnice isplate lizinga koja je oporeziva za davaoca lizinga;</p> <p>7.2. Kupovina imovine datom pod lizing na početku lizinga, lice koja uzima pod lizing ima pravo priznavanja troškova obezvređivanja u vezi sa imovinom primljenoj pod lizing;</p> <p>7.3. Kreditiranje od strane davaoca lizinga za lice koja uzima lizing, sa komponentom isplate kamate isplate lizinga, koja je prihod za za davaoca lizinga i trošak za lice koja uzima lizing. Od davaoca lizinga, ne zahteva se da se zadrži porez na izvoru za kamatu, kada davaoc lizinga je finansijska institucija ovlašćena od Centralne Banke Kosova.</p> <p>8. Operativni lizing po svom značenju je sporazum davanja pod zakup imovine. Isplate lizinga su oporezivi prihodi za</p>
---	--	--

<p>tatueshme për lizingdhënësin dhe shpenzime të zbritshme për lizingmarrësin. Lizingdhënësi ruan të drejtën e zbritjes së shpenzimeve të zhvlerësimit.</p>	<p>expenses to the lessee. The lessor reserves the right to deduct depreciation expenses.</p>	<p>davaoca lizinga i umanjivi troškovi za lice koja uzima lizin. Davaoc lizinga čuva pravo umanjenja troškova obezvređivanja.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Të ardhurat e liruara</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>Exempted incomes</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Izuzeti prihodi</b></p>
<p>1. Të ardhurat e Bankës Qendrore të Kosovës dhe të institucioneve financiare qeveritare ndërkombëtare të lejuara dhe të autorizuara për të vepruar në Kosovë, janë të liruara nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave.</p>	<p>1. The incomes of the Central Bank of Kosovo and international governmental financial institutions approved and authorized to operate in Kosovo are exempted from Corporate Income Tax</p>	<p>1. Prihodi Centralne Banke Kosova i međunarodnih vladinih finansijskih institucija koje imaju dozvolu delovanja na Kosovu su oslobođena od Poreza na Korporativne Prihode.</p>
<p>2. Për qëllime të këtij neni, Institucione financiare qeveritare ndërkombëtare, janë:</p>	<p>2. For the purposes of this Article, international governmental financial institutions are:</p>	<p>2. U svrhe ovog člana, međunarodne vladine finansijske institucije Institucione su:</p>
<p>2.1. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN);</p>	<p>2.1. International Monetary Fund (IMF);</p>	<p>2.1. Međunarodni Monetarni Fond (MMF);</p>
<p>2.2. Banka Botërore - Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) dhe Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA);</p>	<p>2.2. World Bank - International Bank for Reconstruction and Development (IBRD) and International Development Association (IDA);</p>	<p>2.2. Svetska Banka – Međunarodna Banka za Obnovu i Razvoj (MBOR) i Međunarodna Asocijacija za Razvoj (IDA);</p>
<p>2.3. Korporata Ndërkombëtare për Financim (IFC) dhe anëtarët tjerë të Grupit të Bankës Botërore;</p>	<p>2.3. International Finance Corporation (IFC) and other members of the World Bank Group;</p>	<p>2.3. Međunarodna Korporacija za Finansiranje (IFC) i ostali članovi Grupe Svetske Banke;</p>
<p>2.4. Komisioni Evropian (EC);</p>	<p>2.4. The European Commission (EC);</p>	<p>2.4. Evropska Komisija (EC);</p>
<p>2.5. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD);</p>	<p>2.5. European Bank for Reconstruction and Development (EBRD);</p>	<p>2.5. Evropska Banka za Obnovu i Razvoj (EBRD);</p>

<p>2.6. Banka Evropiane për Investim (EIB);</p> <p>2.7. Banka Ndër-amerikane për Zhvillim (IADB);</p> <p>2.8. Banka Aziatike për Zhvillim (ADB);</p> <p>2.9. Banka Afrikane për Zhvillim (AFDB);</p> <p>2.10. Fondi Ndërkombëtar për Zhvillim të Bujqësisë (IFAD);</p> <p>2.11. Banka Islamike për Zhvillim (IDB).</p> <p>3. Kontraktuesi jo-vendor nuk obligohet të regjistrohet në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, por obligohet të njoftoj ATK-në, në formë të shkruar, se është duke punuar në Kosovë.</p> <p>3.1. Kontraktuesi jo-vendor që zhvillon aktivitete të tjera në Kosovë, që janë të ndryshme nga këto në relacion me organizatat e përmendura në këtë nen, regjistrohet në Kosovë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe në ATK. Në ATK regjistrohet duke aplikuar për numrin fiskal ose duke caktuar përfaqësuesin fiskal. Të ardhurat e krijuara nga aktivitetet tjera janë të ardhura të tatueshme.</p>	<p>2.6. European Investment Bank (EIB);</p> <p>2.7. The Inter-American Development Bank (IADB);</p> <p>2.8. Asian Development Bank (ADB);</p> <p>2.9. The African Development Bank (AFDB);</p> <p>2:10. International Fund for Agricultural Development (IFAD);</p> <p>2:11. Islamic Development Bank (IDB).</p> <p>3. The non-local contractor shall not be obliged to register in the Ministry of Trade and Industry in Kosovo, but is obliged to send a written notice to TAK to inform it is working in Kosovo.</p> <p>3.1. The non-local contractor that conducts other activities in Kosovo, which are different from those in relation to the organizations mentioned in this article, shall be registered in Kosovo to the Ministry of Trade and Industry and with TAK. It shall apply for a fiscal number or appoint a fiscal representative. Incomes generated from other activities are taxable income.</p>	<p>2.6. Evropska Investiciona Banka (EIB);</p> <p>2.7. Među-Američka Banka za Razvoj (IADB);</p> <p>2.8. Azijska Banka za Razvoj (ADB);</p> <p>2.9. Afrička Banka za Razvoj (AFDB);</p> <p>2.10. Međunarodni Fond za RAZVOJ Poljoprivrede (IFAD);</p> <p>2.11. Islamska Banka za Razvoj (IDB).</p> <p>3. Ugovarač koji nije domaći nije obavezan da se registruje pri Ministarstvu Trgovine i Industrije na Kosovu, ali se obavezuje da obavesti PAK, u pisanoj formi, da radi na Kosovu.</p> <p>3.1. Ugovarač koji nije domaći i koji obavlja ostale aktivnosti na Kosovu, koje su različite u odnosu na organizacije pomenute u ovom članu, registruju sen a Kosovu pri Ministarstvu Trgovine i Industrije i u PAK. U PAK-u se registruje aplicirajući za fiskalni broj ili određujući fiskalnog predstavnika. Nastali prihodi sa ostalih aktivnosti su oporezivi prihodi.</p>
---	--	--

<p>3.2. Kontraktuesi jo-vendor pavarësisht se a ka ndonjë aktivitet tjetër apo jo, është përgjegjës, qoftë në mënyrë direkte ose nëpërmes të përfaqësuesit të tij fiskal, për përmbushjen e çdo obligimi të mbajtjes së tatimit në burim të aplikueshëm të paraparë në Kapitullin VII të Ligjit.</p> <p>4. Për qëllime të nenit 7, paragrafit 1, nënparagrafit 1.6, të Ligjit, shprehja “organizatat ndërkombëtare ndër-qeveritare”, nënkupton:</p> <p>4.1. Korporata Ndërkombëtare e Financave (IFC) dhe anëtarët tjerë të Grupit të Bankës Botërore;</p> <p>4.2. Banka Ndër-Amerikane për Zhvillim (IADB);</p> <p>4.3. Banka Aziatike për Zhvillim (ADB);</p> <p>4.4. Banka Afrikane për Zhvillim (AFDB);</p> <p>4.5. Banka Islamike për Zhvillim (IDB).</p>	<p>3.2. The non-local contractor, regardless of whether or not it has any other activity, is responsible, either directly or through its fiscal representative for the fulfilment of any obligation of the applicable withholding tax provided in Chapter VII of the Law.</p> <p>4. For the purposes of Article 7, paragraph 1, sub-paragraph 1.6 of the Law, the word "international inter-governmental organizations" means:</p> <p>4.1. International Finance Corporation (IFC) and other members of the World Bank Group;</p> <p>4.2. The Inter-American Development Bank (IADB);</p> <p>4.3. Asian Development Bank (ADB);</p> <p>4.4. The African Development Bank (AFDB);</p> <p>4.5. Islamic Development Bank (IDB).</p>	<p>3.2. Ugovarač koji nije domaći bez obzira da li ima neku drugu aktivnost ili ne, odgovoran je, bilo na direktan način ili kroz njegovog fiskalnog predstavnika, za ispunjenje svake obaveze primenljivog zadržavanja poreza na izvor koji je predviđen na Poglavlju VII Zakona.</p> <p>4. Za svrhe člana 7, stava 1, pod-stava 1.6, Zakona, izraz “međunarodne među-vladine organizacije, podrazumeva:</p> <p>4.1. Međunarodna Korporacija Finansija (IFC) i ostali članovi Grupe Svetske Banke;</p> <p>4.2. Među- Američka Banka za Razvoj (IADB);</p> <p>4.3. Azijska Banka za Razvoj (ADB);</p> <p>4.4. Afrička Banka za Razvoj (AFDB);</p> <p>4.5. Islamska Banka za Razvoj (IDB).</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>E ardhura nga granti, subvencioni dhe donacioni</b></p> <p>1. E ardhura e përfituar sipas nenit 7, paragrafit 1, nënparagrafit 1.7 të Ligjit, është e përjashtuar nëse është në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit.</p> <p>1.1. Tatimpaguesi i cili tatohet në bazë të të ardhurave reale, të ardhurat sipas paragrafit 1 të këtij neni i trajton në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit;</p> <p>1.2. Tatimpaguesi i cili nuk tatohet në bazë të të ardhurave reale, të ardhurat sipas paragrafit 1 të këtij neni i trajton të ardhura të përjashtuara dhe nuk i përfshinë në deklaratën tatimore të periudhës.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>Incomes from grants, subsidies and donations</b></p> <p>1. Income generated under Article 7, paragraph 1, sub-paragraph 1.7 of the Law, is exempted if it is in accordance with the terms and conditions of profitability.</p> <p>1.1. A taxpayer who is taxed on the basis of real income shall handle the incomes under paragraph 1 of this Article in accordance with Kosovo Accounting Standards;</p> <p>1.2. A taxpayer who is not taxed on the basis of real income shall handle the incomes under paragraph 1 of this Article as exempted incomes and shall not include them in the tax declaration period.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Prihodi sa granta, subvencije i donacije</b></p> <p>1. Prihod stečen na osnovu člana 7, stava 1, pod-stava 1.7 Zakona, je izuzet ako je u skladu sa pravilima i uslovima sticanja.</p> <p>1.1. Poreski obveznik koji se oporezuje na osnovu realnih prihoda, prihodi na osnovu stava 1 ovog člana tretira u skladu sa Standardima Računovodstva Kosova;</p> <p>1.2. Poreski obveznik koji se ne oporezuje na osnovu realnih prihoda, prihodi na osnovu ovog člana tretira kao izuzete prihode i ne uključuje ih u poresko izjavljivanje za period.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Shpenzimet e palejueshme</b></p> <p>1. Sipas nenit 8, paragrafit 1 të Ligjit, shpenzimet e mëposhtme konsiderohen shpenzime të palejueshme:</p> <p>1.1. Kostoja e përvetësimit dhe përmirësimit të tokës. Si parim, toka nuk e humb vlerën e saj në kohë dhe nuk i nënshtrohet zhvlerësimit. Përmirësimi përfshin punën e drenazimit, tarracimit,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 12</b> <b>Disallowed expenses</b></p> <p>1. According to Article 8, paragraph 1 of this Law, the following expenses shall be considered as disallowed expenses:</p> <p>1.1. Land acquisition and improvement cost. In principle, land does not lose its value and is not subject to depreciation. The improvement includes drainage work, terracing, sewerage, water supply</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 12</b> <b>Nedozvoljeni troškovi</b></p> <p>1. Na osnovu člana 8, stava 1 Zakona, troškovi u nastavku se smatraju nedozvoljenim troškovima:</p> <p>1.1. Troškovi prisvajanja i poboljšanja zemljišta. U načelu, zemljište ne gubi svoju vrednost prolaskom vremena i ne podvrgava se obezvređivanju. Poboljšanje uključuje radove na drenaži,</p>

<p>kanalizimit, ujësjellësit dhe punë tjera të ngjashme, të cilat bëhen pjesë e tokës dhe rrisin vlerën totale të tokës;</p> <p>1.2. Gjoha, ndëshkimi apo interesi, i shqiptuar nga ndonjë autoritet publik, si dhe shpenzimi që lidhet me to;</p> <p>1.3. TVSH për të cilën tatimpaguesi kërkon zbritje ose kreditim sipas Ligjit për TVSH;</p> <p>1.4. Humbja nga transaksioni ndërmjet personave të lidhur, përveç rastit kur transaksioni është në harmoni me vlerën e hapur të tregut;</p> <p>1.5. Përfitimi në natyrë të cilin punëdhënësi i jep të punësuarit në formë të shujtës dhe transportit, përveç rastit kur është i organizuar nga punëdhënësi, përmes mensës, transportit apo duke kontraktuar një biznes tjetër;</p> <p>1.6. Shpenzimi i pa dokumentuar si dhe shpenzimi i cili nuk përmbushë kriteret e përcaktuara me Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat;</p> <p>1.7. Shpenzimi për qiranë e banesës, për të punësuarin rezident apo jo rezident, pavarësisht nga kushtet e kontratës së punësimit apo shërbimit, përveç rastit kur shpenzimi i tillë përfshihet në pagën bruto të të punësuarit.</p>	<p>and other similar works, which become part of the soil and increase the total value of land;</p> <p>1.2. Fines, penalties or interest imposed by any public authority, as well as related expenses;</p> <p>1.3. VAT for which the taxpayer claims a deduction or credit under the VAT Law;</p> <p>1.4. Loss from transactions between related persons, unless the transaction is in line with the open market value;</p> <p>1.5. Benefits such as meal and transport allowance paid by the employer to the employee except for the case when it is organised by the employer, canteen or by contacting another business;</p> <p>1.6. Undocumented spending and the spending that does not meet the criteria set forth in the Law on Tax Administration and Procedures;</p> <p>1.7. Apartment rent expense for the resident or non-resident employee, regardless of the conditions of the employment or service contract, unless such expenditure is included in the employee's gross salary.</p>	<p>pravljena terasa, kanalizacije, vodovoda i drugih sličnih poslova, koja postaju deo zemljišta i povećavaju ukupnu vrednost zemljišta;</p> <p>1.2. Kazne ili kamata, izdata od nekog javnog autoriteta kao i troškovi vezani za njih;</p> <p>1.3. PDV za koju Poreski obveznik zahteva popust ili kreditiranje na osnovu Zakona o PDV-u;</p> <p>1.4. Gubitak od transakcije između povezanih lica, osim slučaja kada je transakcija u skladu sa vrednošću otvorenog tržišta;</p> <p>1.5. Dobit u naturi koju poslodavac daje zaposlenom u obliku obroka ili prevoza, osim slučaja kada je organiziran od poslodavca, kroz menzu, prevoza ili na osnovu ugovora sa drugim biznisom;</p> <p>1.6. Nedokumentovani trošak kao i trošak koji ne ispunjuje kriterijume određene Zakonom o Poreskoj i Administraciji i Procedurama;</p> <p>1.7. Trošak o zakupu stana, za rezidentnog ili ne-rezidentnog zaposlenog, bez obzira na uslove ugovora o zapošljavanju ili usluge, osim kada takav trošak se uključuje na bruto isplatu zaposlenog.</p>
---	---	---



<p>2. Kontributi pensional dhe sigurimi shëndetësor, mbi shumën maksimale të lejuar me ligjet përkatëse.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b> <b>Shpenzimet e lejueshme</b></p> <p>1. Sipas nenit 9, paragrafit 1 të Ligjit, biznesi me të ardhura vjetore bruto prej pesëdhjetëmijë euro (50.000 €) e më shumë, dhe biznesi i cili ka zgjedhur të mbaj libra dhe regjistrime siç kërkohet në nenin 35 të Ligjit, zbret shpenzimet e lejuara, të paguara apo të akruara gjatë periudhës tatimore, me përjashtim të shpenzimeve të përcaktuara në nenin 9, paragrafin 5 të Ligjit.</p> <p>2. Neni 9, paragrafi 2 i Ligjit, ka paraparë zbritjen e shpenzimeve të edukimit, të paguara nga një punëdhënës për të punësuarin, nëse plotësohen kushtet si në vijim:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Pagesa e drejtpërdrejtë e përcaktuar në nenin 9, paragrafin 2, nënparagrafin 2.1 të Ligjit, bëhet nga llogaria bankare e punëdhënësit për institucionin edukativo/arsimor. Në të kundërtën, nëse pagesa i është bërë të punësuarit dhe i punësuarit vetë ka bërë pagesat, atëherë kjo përfshihet në të ardhurat bruto të të punësuarit dhe i nënshtrohet</p>	<p>2. Pension contribution and health insurance on the maximal amount allowed with the respective laws.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 13</b> <b>Allowed Expenses</b></p> <p>1. According to Article 9, paragraph 1 of the Law, the business with a gross annual income of euros fifty thousand (€50.000) and more as well as the business that has chosen to keep books or records as required in Article 35 of the Law, shall deduce the allowed, paid or accrued expenses incurred during the tax period, except for the expenses set forth in Article 9, paragraph 5 of the Law.</p> <p>2. Article 9, paragraph 2 of the law sets forth the deduction of educational expenses paid by the employer to the employee provided that:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. the direct payments as defined in article 9, paragraph 2, sub-paragraph 2.1 of the Law, are made from the employer's bank account to the educational institution. If the payment is otherwise made to the employee and the employee has made the payments himself, then it shall be included in the employee's gross income and shall be</p>	<p>2. Penzijski doprinos i zdravstveno osiguranje, iznad maksimalnog iznosa dozvoljen dotičnim zakonima.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 13</b> <b>Dozvoljeni troškovi</b></p> <p>1. Na osnovu člana 9, stava 1 Zakona, biznis sa godišnjim bruto prihodom od pedeset hiljada evra (50.000 €) i više, i biznis koji je odabrao da održi knjige i registrovanja kao što se zahteva članom 35 Zakona, odbije dozvoljene troškove, isplaćene ili obračunate tokom poreskog perioda, sa izuzetkom troškova određenim članom 9, stav 5 Zakona.</p> <p>2. Član 9, stav 2 Zakona, je predvideo odbitak troškova obrazovanja, isplaćenih od strane poslodavca za zaposlenog, ako se ispunjuju sledeći uslovi:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Direktna isplata određena članom 9, stav 2, pod-stav 2.1 Zakona, se izvrši od bankarskog računa poslodavca za edukativnu/obrazovnu instituciju. U protivnom, ako je isplata obavljena zaposlenom i zaposleni je sam obavio isplate, onda se to uključuje na bruto prihode zaposlenog i podvrgava se zadržavanju poreza na izvor;</p>
---	---	---

<p>mbajtjes së tatimit në burim;</p> <p>2.2. Institucioni edukativ/arsimor është i pranuar sipas legjislacionit përkatës në Kosovë. Shprehja “i pranuar” në këtë nen nënkupton që certifikata/diploma që përfiton i punësuari, njihet nga Institucionet përkatëse në Kosovë;</p> <p>2.3. Edukimi/arsimi lidhet me pozitën e të punësuarit dhe nuk e kualifikon atë të punësuar për punë në një profesion tjetër;</p> <p>2.4. Neni 9, paragrafi 2, nënparagrafi 2,4 i Ligjit, kërkon që i punësuari pas përfundimit të edukimit për të cilin janë paguar shpenzimet nga punëdhënësi, të qëndrojë në marrëdhënie punësimi me punëdhënësin për një periudhë minimale. Për qëllime të këtij nënparagrafi, periudha minimale do të jetë 24 muaj;</p> <p>2.4.1. Shuma e shpenzimit të zbritur në emër të edukimit për të punësuarin i cili ka ndërprerë marrëdhënien e punës para 24 muajve, njihet e ardhur për biznesin, në periudhën kur i punësuari ka ndërprerë punën.</p> <p>3. Për njohjen e shpenzimeve të trajnimit siç është përcaktuar në nenin 9, paragrafin</p>	<p>subject to withholding taxation;</p> <p>2.2. Educational institution is recognised according to respective legislation applicable in Kosovo. “Recognised” shall mean the certificate / diploma that benefits the employee, recognized by the relevant institutions in Kosovo;</p> <p>2.3. education relates to the employee’s position and does not qualify the employee for;</p> <p>2.4. Article 9, paragraph 2, subparagraph 2.4 of the Law, requires that employee shall be employed by the employer following the completion of education for which the expenses are paid by the employer for a minimal period of time. For the purposes of this sub-paragraph, the minimal period shall be 24 months;</p> <p>2.4.1. The amount of deduction on behalf of education for employee who terminated its employment prior to 24 months, shall be recognised as an income for the business for the period when the employee has stopped working.</p> <p>3. In order to recognise the training expenses defined in article 9, paragraph 3</p>	<p>2.2. Edukativna/obrazovna institucija je prihvaćena na osnovu dotičnog zakonodavstva na Kosovu. Izraz “prihvaćen” na ovom članu podrazumeva da certifikat/diploma koju dobije zaposleni, priznaje se od dotičnih institucija na Kosovu;</p> <p>2.3. Edukacija/obrazovanje se povezuje sa pozicijom zaposlenog i ne kvalifikuje tog zaposlenog za rad u drugoj profesiji;</p> <p>2.4. Član 9, stav 2, pod-stav 2,4 Zakona, zahteva da zaposleni nakon završetka obrazovanja za koju su isplaćeni troškovi od poslodavca, da ostane u radnom odnosu sa poslodavcem za minimalni period. Za ciljeve ovog pod-stava, minimalni period će biti 24 meseci;</p> <p>2.4.1. Iznos odbijenog troška u ime obrazovanja za zaposlenog koji je prekinuo radni odnos pre 24 meseci, se priznaje kao prihod za biznis, za period kada je zaposleni prekinuo radni odnos.</p> <p>3. Za priznavanje troškova obuke kao što je određeno članom 9, stav 3 Zakona, treba da</p>
--	---	--

<p>3 të Ligjit, duhet të trajtohen shpenzimet për ndjekjen e programit dhe shpenzimet për jetesë gjatë ndjekjes së trajnimit.</p> <p>3.1. Për njohjen e shpenzimeve për ndjekjen e programit, duhet të plotësohen kushtet si në vijim:</p> <p>3.1.1. Shpenzimet e trajnimit paguhen drejtpërdrejtë nga punëdhënësi për institucionin që ofron trajnimin;</p> <p>3.1.2. Pagesa për shpenzimet e trajnimit bëhet përmes llogarisë bankare;</p> <p>3.1.3. Trajnimi është në funksion të aktivitetit ekonomik të biznesit;</p> <p>3.1.4. Trajnimi është i lidhur drejtpërdrejtë me pozitën e të punësuarit, bazuar në kontratën e punës;</p> <p>3.1.5. I punësuarit, pas përfundimit të trajnimit, qëndron së paku 24 muaj në marrëdhënie pune me punëdhënësin;</p> <p>3.1.6. Shuma e shpenzimit të zbritur në emër të trajnimit për të punësuarin i cili ka ndërprerë marrëdhënien e punës para 24 muajve, njihet e ardhur për biznesin,</p>	<p>of the law, expenses related to the training attendance and subsidence costs should be handled.</p> <p>3.1. In order to recognise the training attendance costs, the following criteria should be met:</p> <p>3.1.1. Training expenses paid directly by the employer to the institution providing the training;</p> <p>3.1.2. Paying for the training cost is done through bank account;</p> <p>3.1.3. Training serves to the economic business activity;</p> <p>3.1.4. The training is directly related to the employee's position, based on the employment contract;</p> <p>3.1.5. The employee, after training, shall hold at least 24 months of employment relationship with the employer;</p> <p>3.1.6. The amount of deduction on behalf of education for employee who terminated its employment prior to 24 months, shall be recognised as an income for the business for the</p>	<p>se tretiraju troškovi za praćenje programa i životni troškovi tokom praćenja obuke.</p> <p>3.1. Za priznavanje troškova za praćenje programa, treba da se ispune sledeći uslovi:</p> <p>3.1.1. Troškovi obuke se isplaćuju direktno od poslodavca za instituciju koja pruža obuku;</p> <p>3.1.2. Isplata za troškove obuke se vrše kroz bankarski račun;</p> <p>3.1.3. Obuka je u funkciji ekonomske aktivnosti biznisa;</p> <p>3.1.4. Obuka je direktno povezana sa pozicijom zaposlenog, na osnovu radnog ugovora;</p> <p>3.1.5. Zaposleni, nakon završetka obuke, ostaje najmanje 24 meseci u radnom odnosu sa poslodavcem;</p> <p>3.1.6. Iznos odbijenog troška u ime obuke za zaposlenog koji je prekinuo radni odnos pre 24 meseci, priznaje se kao prihod za biznis, za period kada je zaposleni prekinuo</p>
---	---	---

<p>në periudhën kur i punësuari ka ndërprerë punën;</p> <p>3.2. Shuma e shpenzimeve të lejuara për jetesë gjatë ndjekjes së programit të trajnimit, trajtohet sipas Udhëzimit Administrativ për Tatim në të Ardhura Personale.</p> <p>4. Neni 9, paragrafi 5 i Ligjit ka paraparë që nuk lejohet zbritje për çdo shpenzim të përlllogaritur për atë periudhë tatimore lidhur me të ardhurat të cilat i nënshtrohen tatimit të mbajtur në burim, përveç nëse janë paguar shpenzimet më ose para datës 31 mars të vitit pasues. Nëse shpenzimet e ndodhura janë paguar pas datës 31 mars të vitit pasues, njihen në periudhën në të cilën është bërë pagesa.</p> <p>5. Neni 9, paragrafi 6 i Ligjit, i referohet shpenzimeve në lidhje me lizingun operativ dhe financiar. Shpenzimet e tilla trajtohen sipas nenit 9 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p>6. Për t'u lejuar si të zbritshme, shpenzimet duhet të jenë plotësisht të dokumentuara dhe të jenë në dispozicion për inspektim, me kërkesë nga Administrata Tatimore. Kërkesat për dokumentacion janë paraparë në Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat.</p> <p>7. Për të përcaktuar koston e mallit të</p>	<p>period when the employee has stopped working;</p> <p>3.2. The allowed subsidence amount for attending the training program shall be handled by the AI on Personal Income Tax.</p> <p>4. Article 9, paragraph 5 of the Law sets forth that No deduction shall be allowed for any expense incurred based on an obligation of source withholding, unless such expenses are paid on or before 31 March of the subsequent tax period. If the incurred expenses are paid after 31st of March of the following, they shall be recognised for the period in which the payment is made.</p> <p>5. Article 9, paragraph 6 of the law refers to expenses with respect to operational leasing and financial leasing. Such expenses shall be handled according to Article 9 of this Administrative Instruction.</p> <p>6. In order to be allowed as deductible, expenses must be fully documented and be available for inspection upon request from Tax Administration. Documentation requirements are stipulated in the Law on Tax Administration and Procedures.</p> <p>7. In order to determine the cost of goods</p>	<p>radni odnos;</p> <p>3.2. Iznos dozvoljenih troškova za život tokom praćenja programa obuke, tretira se na osnovu Administrativnog Uputstva o Porezu na Lični Dohodak.</p> <p>4. Član 9, stav 5 Zakona je predvideo da se ne dozvoljava odbijanje za svaki trošak izračunat za taj poreski period u vezi sa prihodima koji se podvrgavaju zadržanom porezu na izvor, osim ako su isplaćeni troškovi na ili pre datuma 31 mart naredne godine, priznaju se za period za koji je izvršena isplata.</p> <p>5. Član 9, stav 6 Zakona, odnosi se na troškove u vezi sa operativnim ili finansijskim lizingom. Takvi troškovi se tretiraju prema članu 9 ovog Administrativnog Uputstva.</p> <p>6. Da bi se priznali kao odbijanje troškova moraju biti potpuno dokumentovani i biti na raspolaganju za uvid na zahtev Poreske Administracije. Zahtevi za dokumentaciju su propisane Zakonom o Poreskoj Administraciji i Procedurama.</p> <p>7. Da bi se odredili troškovi prodate robe,</p>
---	--	--

<p>shitur, tatimpaguesi përdor një të një nga metodat e lejuara të udhëheqjes së stoqeve sipas Standardeve Kosovare të Kontabilitetit, me përjashtim të metodës LIFO.</p> <p>7.1. Metoda që zgjidhet për udhëheqjen e stoqeve, shfrytëzohet për vitin në të cilin është zgjedhur dhe së paku për tri periudha tjera tatimore në vazhdim;</p> <p>7.2. Tatimpaguesi i cili dëshiron të ndryshojë këtë metodë, pas asaj periudhe kohore të obligueshme, kërkon shpjegim individual nga Administrata Tatimore e Kosovës.</p>	<p>sold, the taxpayer shall use one of the methods allowed for the stock management according to the Kosovo Accounting Standards, excluding LIFO method.</p> <p>7.1. The method chosen for assets management shall be used for the year it was chosen for and for at least three other tax periods;</p> <p>7.2. A taxpayer willing to change this method, after the obligatory period is due, shall require individual explanation by the Tax Administration of Kosovo.</p>	<p>Poreski obveznik koristi jednu od metoda dozvoljenih za vođenje zaliha na osnovu Standarda Računovodstva Kosova, osim metode LIFO.</p> <p>7.1. Izabrana metoda za vođenje zaliha, koristi se za godinu u kojoj je izabrana i najmanje za tri naredna poreske periode;</p> <p>7.2. Poreski obveznik koji želi da promeni ovu metodu, nakon obaveznog perioda, zahteva individualno objašnjenje od strane Poreske Administracije Kosova.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Zbritjet e lejuara për aktivitetet me interes publik</b></p> <p>1.Limiti i lejuar prej dhjetë për qind (10%), siç është përcaktuar në nenin 10, paragrafin 1 të Ligjit, për kontributet e dhëna nga tatimpaguesi për interes publik, aplikohet në fitimin para tatimit, përpara se një shpenzim i këtillë të jetë zbritur nga të ardhurat e rregulluara bruto.</p> <p>2.Tatimpaguesi i cili kërkon zbritje të shpenzimeve në lidhje me kontributin bamirës të dhënë gjatë periudhës tatimore, siguron fletë-dëshminë e pagesës së nënshkruar dhe vulosur nga ana e përfituesit të kontributit bamirës, që</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 14</b> <b>Allowed deduction for public interest activities</b></p> <p>1. As provided in paragraph 1 of Article 28 of the Law, ten per cent (10%) allowed limit, for contributions given by the taxpayer for public interest will be applied on the gross profit before such an expense is deducted from adjusted gross income.</p> <p>2. A taxpayer who claims a deduction in respect of charitable contributions made during the tax period shall furnish receipts signed and stamped by the beneficiaries of the charitable contributions, confirming the purpose of those donations, the amounts</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 14</b> <b>Dozvoljeni odbici za aktivnosti od javnog interesa</b></p> <p>1. Dozvoljena granica od deset procenata (10 %) , kao što je definisano u članu 10, stav 1 Zakona, za dati doprinos od strane Poreskog obveznika za javni interesa, primenjuje se na dobit pre oporezivanja, pre nego što takav trošak se odbija od uređenih bruto prihoda.</p> <p>2. Poreski obveznik koji zahteva odbitak troškova vezanih za dobrotvorne priloge datom tokom poreskog perioda obezbeđuje dokaz o uplati potpisan i overen od strane korisnika dobrotvornog priloga, koji potvrđuje svrhu, iznos i vremenski raspored</p>

<p>vërteton qëllimin, shumën dhe kohën e donacionit të dhënë.</p> <p>2.1 Zbritje e kontributit bamirës kërkohet vetëm nga tatimpaguesi i cili paguan tatim në bazë të të ardhurave reale;</p> <p>2.2 Tatimpaguesi i cili nuk i nënshtrohet tatimit në të ardhura reale, nuk mund të kërkojë këtë zbritje;</p> <p>3. Fletë-dëshmia e referuar në paragrafin 2 të këtij neni përmban informatat, si në vijim:</p> <p>3.1. Emrin e donatorit;</p> <p>3.2. Numrin identifikues tatimor (numrin fiskal) të donatorit;</p> <p>3.3. Adresën e donatorit;</p> <p>3.4. Emrin e personit kontaktues të donatorit dhe numrin e telefonit;</p> <p>3.5. Emrin e pranuesit;</p> <p>3.6. Numrin identifikues tatimor (numrin fiskal) të pranuesit;</p> <p>3.7. Adresën e pranuesit;</p> <p>3.8. Emrin e personit kontaktues të pranuesit dhe numrin e telefonit;</p>	<p>and the times when the donations were made.</p> <p>2.1 A charitable contribution deduction can only be claimed by a taxpayer who pays tax on a real income basis;</p> <p>2.2 2.4 A taxpayer, who is not subject to real income tax, may not require such a deduction;</p> <p>3. Each receipt referred to in the paragraph 2 shall contain the following information:</p> <p>3.1. Name of the donor;</p> <p>3.2. Tax identification number (fiscal number) of the donor;</p> <p>3.3. Address of the donor;</p> <p>3.4. Name of contact person and phone number of the donor;</p> <p>3.5. Name of the recipient;</p> <p>3.6. Tax identification number (fiscal number) of the recipient;</p> <p>3.7. Address of the recipient;</p> <p>3.8. Name of contact person and phone number of the recipient;</p>	<p>date donacije.</p> <p>2.1 Odbitak dobrotvornog doprinosa se zahteva samo od poreskog obveznika koji plaća porez na osnovu realnih prihoda;</p> <p>2.2 Poreski obveznik koji se ne podvrgava oporezivanju na realne prihode, ne može da zahteva ovaj odbitak;</p> <p>3. Dokaz referisan u stavu 2 ovog člana sadrži sledeće informacije:</p> <p>3.1. Ime donatora;</p> <p>3.2. Identifikacioni poreski broj (fiskalni broj) donatora;</p> <p>3.3. Adresu donatora;</p> <p>3.4. Ime kontaktnog lica donatora i telefonski broj;</p> <p>3.5. Ime primaoca;</p> <p>3.6. Identifikacioni poreski broj (fiskalni broj) primaoca;</p> <p>3.7. Adresu primaoca;</p> <p>3.8. Ime kontaktnog lica primaoca i telefonski broj;</p>
---	---	--

<p>3.9. Shumën e kontributit bamirës të dhuruar;</p> <p>3.10. Datën e dhënies së donacionit;</p> <p>3.11. Deklaratën e pranuesit se të dhënat në fletë - dëshmi janë të sakta dhe se pranuesi nuk ka konflikt direkt apo indirekt të interesit me donatorin.</p> <p>4. Përveç zbritjes së lejuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, tatimpaguesi që kontribuon në fusha të caktuara të rregulluara me ligje të veçanta në Kosovë, i lejohet zbritje shtesë deri në dhjetë përqind (10%) të fitimit para tatimit.</p>	<p>3.9. The amount of the charitable contribution donated;</p> <p>3.10. Date of donation;</p> <p>3.11. A declaration by the recipient that the data on the receipt is correct and that the recipient has no direct or indirect conflict of interest with the donor.</p> <p>4. In addition to the deduction allowed under paragraph 1 of this Article, the taxpayer contributes in certain areas regulated by specific laws in Kosovo, additional deduction shall be allowed up to ten per cent (10%) of profit before tax.</p>	<p>3.9. Iznos darivanog dobrotvornog priloga;</p> <p>3.10. Datum davanja donacije;</p> <p>3.11. Izjavu primaoca da podaci na uverenju su tačni i da primalac nema direktnog ili indirektnog konflikta sa donatorom.</p> <p>4. Osim dozvoljenog odbitka na osnovu stava 1 ovog člana, Poreski obveznik koji doprinosi na određena područja regulisana posebnim zakonima na Kosovu, se dozvoljava dodatni odbitak do deset procenata (10%) dobiti pre oporezivanja.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Shpenzimet e borxhit të keq</b></p> <p>1. Bazuar në nenin 12 të Ligjit, kur një pagesë nuk është arkëtuar plotësisht apo pjesërisht për një shitje dhe është shpallur si e pa mbledhshme, konsiderohet borxh i keq dhe shuma e pa arkëtuar, lejohet shpenzim i periudhës në të cilën është njohur borxhi i keq.</p> <p>2. Neni 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.1 i Ligjit, kërkon që borxhet e këqija të “shlyhen” nga evidencat kontabël. Në termin e kontabilitetit “shlyhen” do të thotë</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 15</b> <b>Bad debt costs</b></p> <p>1. Pursuant to Article 12 of the law, payment which is not fully or partly received and is declared as uncollectible shall be considered bad debt and the amount of uncollectible allowed expense in the period in which the bad debt is recognized.</p> <p>2. Article 12, paragraph 1, sub-paragraph 1.5.1 of the Law, requires bad debts to be 'written off' from accounting records. In accounting terms “written off” means an</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 15</b> <b>Troškovi lošeg duga</b></p> <p>1. Na osnovu člana 12 Zakona, kada jedna isplata nije inkasirana u potpunosti ili delimično za neku prodaju i izjavljivan je neprikupljivim, smatra se lošim dugom i ne-inkasirani iznos se dozvoljava kao odbitak troška perioda u kojem je priznat loši dug.</p> <p>2. Član 12, stav 1, pod-stav 1.5.1 Zakona, zahteva da se loši dugovi “otpišu” sa evidencija računovodstva. U terminologiji računovodstva “otpisati” podrazumeva da</p>

<p>që është bërë një rregullim në librat e tatimpaguesit për të reflektuar uljen e vlerës së llogarive të arkëtueshme. Duhet të jetë bërë një rregullim në librat e tatimpaguesit për të pasqyruar shpenzimin aktual të borxhit të keq, duke u bazuar në ato borxhe të veçanta që i plotësojnë kushtet siç janë përcaktuar në nenin 12 të Ligjit.</p> <p>3. Siç është paraparë në nenin 12, paragrafin 2 të Ligjit, çdo borxh i keq që është zbritur si shpenzim dhe që më vonë është mbledhur, përfshihet në të ardhurat në periudhën tatimore në të cilën është bërë mbledhja.</p> <p>4. Shuma e pa arkëtuar nuk konsiderohet borxh i keq nëse procedurat për ta shpallur borxh të keq nuk janë iniciuar brenda 24 muajve nga data e obligimit për pagesë.</p> <p>5. Në rastin e shpalljes së një borxhi të keq, shitësi lëshon një faturë të borxhit të keq, në të cilën shënohet "borxh i keq", vlerat përkatëse që korrigjohen, numrin rendor, nr. serik, datën e faturës së furnizimit me të cilën lidhet ky borxh. Kjo faturë përdoret nga shitësi për të zvogëluar të ardhurën ndërsa nga blerësi për të zvogëluar shpenzimin.</p>	<p>adjustment has been made in the taxpayer's books to reflect the reduction in value of accounts receivable. An adjustment in the taxpayer's books must be made to reflect current spending and bad debt, based on those specific debts that meet the requirements as set out in Article 12 of the Law.</p> <p>3. As provided in Article 12, paragraph 2 of the Law, any bad debts that are deducted as expenses and then collected later shall be included in income in the tax period in which the collection has been made.</p> <p>4. The amount of uncollectible bad debt is not considered if the proceedings to declare it a bad debt are not initiated within 24 months from the date of obligation to pay.</p> <p>5. In case of declaration of a bad debt, the vendor sends a bad debt invoice, stating the "bad debt", the respective values are adjusted, serial number, date of receipt of the relevant supply with which the debt relates to. This bill is used by the vendor to reduce the income while the purchaser to reduce spending.</p>	<p>je izvršeno uređenje u knjigama Poreskog obveznika da bi odrazila tekući trošak lošeg duga, na osnovu onih posebnih dugova koji ispunjavaju uslove kao što su određene članom 12 Zakona.</p> <p>3. Kao što je predviđeno članom 12, stav 2 Zakona, svaki loši dug koji je odbijen kao trošak i koji je kasnije prikupljen, uključuje se na prihode poreskog perioda u kojem je prikupljen.</p> <p>4. Ne-inkasirani iznos ne smatra se lošim dugom ukoliko nisu pokrenute procedure za izjavljivanje lošeg duga unutar 24 meseci od datuma obaveze za isplatu.</p> <p>5. U slučaju izjavljivanja lošeg duga, prodavac izdaje jedan račun lošeg duga, u kojem se napiše "loš dug", dotični iznosi se ispravljaju, redni broj, serijski broj, datum računa snabdevanja kojim se povezuje ovaj dug. Ovaj račun se koristi od prodavca za smanjenje prihoda dok od kupca za smanjenje troška.</p>
--	---	---



<p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b> <b>Pagesat për personat e lidhur</b></p> <p>Neni 14 i Ligjit, parasheh që kompensimi, pagat, interesi, qiraja dhe shpenzimet tjera të paguara për personat e lidhur, lejohen si zbritje në një shumë të barabartë me shumën e paguar, por jo më të lartë se vlera e hapur e tregut.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 16</b> <b>Payments to related persons</b></p> <p>Article 14 of the Law provides that compensation, wages, interest, rent and other expenses paid to related persons shall be allowed as a deduction in an amount equal to the lesser of the amount paid and the respective open market value</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 16</b> <b>Isplate za povezana lica</b></p> <p>Član 14 Zakona, predviđa da nadoknada, kamate, kirija i ostali troškovi isplaćeni za povezano lice, se dozvoljavaju kao odbitak u jednakom iznosu sa isplaćenim iznosom, ali ne većim od vrednosti otvorenog tržišta.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 17</b> <b>Zhvlerësimi</b></p> <p>1. Në bazë të nenit 15, paragrafit 1 të Ligjit, vetëm pronari i pasurive të prekshme që shfrytëzohen për zhvillimin e aktivitetit ekonomik, për të cilat mban rrezikun e konsumimit, prishjes apo vjetërsimit të mjeteve, ka të drejtë të zbres shpenzimet e zhvlerësimit.</p> <p>1.1. Nuk lejohet zbritja e zhvlerësimit për qiramarrësin e aseteve, përveç nëse është përcaktuar në marrëveshjen e qirasë se është i përfshirë lizingu financiar dhe të drejtat e pronësisë kalojnë mbi qiramarrësin nga qiradhënësi përmes pagesave periodike.</p> <p>2. Shpenzimet për përmirësimin e pronës së dhënë me qira mbulohen përmes zbritjeve të zhvlerësimit duke përdorur metodën lineare të bazuar në kohëzgjatjen e kontratës së qirasë.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 17</b> <b>Depreciation</b></p> <p>1. Pursuant to paragraph 1 of Article 15 of the Law only the owner of the tangible property, used for developing an economic activity, who bears the risk of wear, tear or obsolescence of the asset, is entitled to deduct depreciation charges.</p> <p>1.1. No depreciation deduction will be allowed for the lessee of the assets unless it is stipulated in the lease agreement that a financial lease is involved and ownership rights pass over to the lessee from the lessor through periodic payments.</p> <p>2. Expenditures on leasehold improvements will be recovered through depreciation deductions using the straight line method based on the duration of the leasehold contract.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 17</b> <b>Obezvredivanje</b></p> <p>1. Na osnovu člana 15, stava 1 Zakona, samo vlasnik materijalne imovine koja se koristi za obavljanje ekonomske aktivnosti, za koje nosi rizik potrošnje, kvara ili zastarevanja sredstava, ima pravo da odbija troškove obezvređivanja.</p> <p>1.1. Ne dozvoljava se odbijanje obezvređivanja za zakupca imovine, osim ako nije određeno tako na osnovu ugovora o zakupu da je uključen i finansijski lizing i vlasnička prava prelaze na zakupca kroz periodične isplate.</p> <p>2. Troškovi za poboljšanje imovine datom pod zakup se pokrivaju kroz odbitke za obezvređivanje koristeći linearnu metodu na osnovu vremenskog trajanja ugovora o zakupu.</p>

<p>2.1. Në rastin e kontratave të qirasë të pa afatizuara, ose kur kohëzgjatja e kontratës së qirasë zgjatet shpesh, sipas gjykimit më të mirë të qiramarrësit dhe bazuar në rregullat e kontabilitetit, si dhe praktikat më të mira, duhet të përcaktoj kohëzgjatjen e kontratës së qirasë dhe ta shfrytëzojë atë si emërues për llogaritjen e shpenzimeve vjetore të zhvlerësimit për përmirësim;</p> <p>2.2. Në rastet kur qiradhënësi dhe qiramarrësi arrijnë marrëveshje që në vend të pagesës së qirasë të kompensohen përmes investimeve që do t'i bëjë qiramarrësi, atëherë ky transaksion këmbimi do të trajtohet transaksion për konsideratë. Për vlerën e investimit të bërë nga qiramarrësi, do t'i faturoj qiradhënësit. Po ashtu, vlerën e njëjtë, qiradhënësi do ta konsideroj të hyrë nga qiraja dhe do t'i faturoj qiramarrësit. Qiramarrësi do ta konsideroj këtë faturë si shpenzim / parapagim të qirasë dhe do të mbajë tatimin në burim në qira për qiradhënësin.</p> <p>3. Për njohjen e shpenzimeve të zhvlerësimit përdoret metoda lineare. Duke pasur parasysh normat e zhvlerësimit për secilën kategori të aseteve të përcaktuara në paragrafin 3 dhe 4 të nenit 15 të Ligjit, kjo</p>	<p>2.1. In the case of open ended leaseholds or when the duration of the leasehold is extended frequently, the lessee shall, at the best of his or her judgment, and based on accounting rules and best practices, define the leasehold duration and use that as the denominator for computing the annual depreciation charge;</p> <p>2.2. In case the lessor and Lessee reach an agreement that instead of paying rent to be compensated through investments made by the Lessee, then this exchange transaction is treated as transaction for consideration. The lessee charges, the lessor for the value of the investments made. Further on, the same value is considered by the lessor as an income from rent and charges the lessee. Lessee considers this spending bill/payment of rent and the same holds withholding tax on rent to the lessor.</p> <p>3. Straight-line method is used to recognize depreciation expense, taking into account the depreciation rates of asset categories defined in paragraph 3 and 4 of Article 15 of the Law, as follows:</p>	<p>2.1. U slučaju ne oročenih zakupa, ili kada trajanje zakupa se produžava često, u skladu sa najboljom presudom od zakupca i na osnovu računovodstvenih pravila kao i najboljih praksi, treba da odredi trajanje ugovora o zakupu i da ga koristi kao imenilac za obračun godišnjih troškova obezvređivanja za ispravku;</p> <p>2.2. U slučajevima kada davalac zakupa i zakupac postignu sporazum da umesto plaćanja zakupnine se kompenzuje kroz investicije koje će izvršiti zakupac, onda ova razmena transakcija će biti tretirana kao transakciju za razmatranje. Za vrednost investicije od strane zakupca, će fakturisati davaocu zakupa. Isto tako, isti iznos vlasnik će smatrati prihodom od zakupnine i fakturisaće zakupcu. Zakupac će razmotriti ovaj račun kao trošak/isplatu zakupnine i zadržaće porez po odbitku na zakupninu za davaoca zakupa.</p> <p>3. Za priznavanje troškova obezvređivanja koristi se linearna metoda. Imajući u vidu stope obezvređivanja za svaku kategoriju imovine određena u stavu 3 i 4 člana 15 Zakona, to podrazumeva:</p>
--	---	---

<p>do të thotë se:</p> <p>3.1. Për kategorinë e parë të aseteve, aplikohet norma e zhvlerësimit 5%, asetit zhvlerësohet në shuma të barabarta gjatë 20 periudhave tatimore;</p> <p>3.2. Për kategorinë e dytë të aseteve, aplikohet norma e zhvlerësimit 20%, asetit zhvlerësohet në shuma të barabarta gjatë 5 periudhave tatimore;</p> <p>3.3. Për kategorinë e tretë të aseteve, aplikohet norma e zhvlerësimit 10%, asetit zhvlerësohet në shuma të barabarta gjatë 10 periudhave tatimore.</p> <p>4. Evidenca e aseteve duhet të vazhdojë të mbahet edhe pas njohjes së zhvlerësimit të plotë deri në kohën e shitjes, shkatërrimit, dhurimit apo mënyrë tjetër të tjetërsimit.</p> <p>5. Pasuritë për qëllime të zhvlerësimit merren parasysh vetëm kur ato janë të vëna në përdorim.</p> <p>5.1. Nuk lejohet zbritje për zhvlerësim nëse një pasuri nuk është vënë në përdorim dhe në qoftë se nuk i shërben qëllimit të aktivitetit ekonomik;</p> <p>5.2. Zhvlerësimi i vitit të plotë (1/1) kërkohet në lidhje me pasuritë që janë vënë në përdorim në gjashtëmujorin e</p>	<p>3.1. For the first category of assets, the depreciation rate applied is 5% and the asset is depreciated in equal amounts over 20 tax periods;</p> <p>3.2. For the second category of assets, the depreciation rate applied is 20% and the asset is depreciated in equal amounts over 5 tax periods;</p> <p>3.3. For the third category of assets, the depreciation rate applied is 10% and the asset is depreciated in equal amounts over 10 tax periods.</p> <p>4. Assets records shall continue to be held after the depreciation was fully recognized by the time of the sale, disposal, donation or other means of disposal.</p> <p>5. For depreciation purposes, assets shall first be accounted for only when they are put to service.</p> <p>5.1. No depreciation deduction will be allowed if an asset is not put to service and if it does not fit the purpose of economic activity;</p> <p>5.2. A full depreciation (1/1) can be claimed in respect of assets that are placed into service during the first six</p>	<p>3.1. Za prvu kategoriju imovine, primenjuje se stopa obezvređivanja od 5%, imovina se obezvređuje u jednakim iznosima tokom 20 poreska perioda;</p> <p>3.2. Za drugu kategoriju imovine, primenjuje se stopa obezvređivanja od 20%, imovina se obezvređuje u jednakim iznosima tokom 5 poreska perioda;</p> <p>3.3. Za treću kategoriju imovine, primenjuje se stopa obezvređivanja od 10%, imovina se obezvređuje u jednakim iznosima tokom 10 poreska perioda.</p> <p>4. Evidencija imovine treba da se nastavi sa održavanjem i nakon priznavanja potpune obezvređivanja do vremena prodaje, uništavanja, darivanja ili drugog načina otuđivanja.</p> <p>5. Imovina u svrhi obezvređivanja se uzima u obzir samo kada su one data na korišćenje.</p> <p>5.1. Ne dozvoljava se odbitak za obezvređivanje ukoliko jedna imovina nije data na korišćenje i ukoliko ne služi svrsi ekonomske aktivnosti;</p> <p>5.2. Obezvređivanje cele godine (1/1) zahteva se u vezi sa imovinom koja je data na korišćenje u prvoj polovini</p>
--	--	---

<p>parë të vitit;</p> <p>5.3. Zhvlerësimi i pjesshëm (1/2) kërkohet në lidhje me pasuritë që janë vënë në përdorim në gjashtëmujorin e dytë të vitit.</p> <p>5.3.1. Nëse është njohur zhvlerësimi i plotë në vitin e parë të përdorimit, për pasurinë që shitet apo tjetërsohet në gjashtëmujorin e parë të vitit, nuk njihet zhvlerësim në vitin e shitjes apo tjetërsimit. Mirëpo, për pasurinë që shitet apo tjetërsohet në gjashtëmujorin e dytë, atëherë zhvlerësimi në vitin e shitjes apo tjetërsimit njihet vetëm për gjashtëmujorin e parë;</p> <p>5.3.2. Nëse është njohur zhvlerësimi i pjesshëm në vitin e parë të përdorimit, dhe shitja apo tjetërsimi i pasurisë ndodh në gjashtëmujorin e dytë, atëherë zhvlerësimi në vitin e shitjes apo tjetërsimit njihet vetëm për gjashtëmujorin e parë.</p> <p>6. Blerja e një pasurie me vlerën deri në një mijë (1,000) euro lejohet si shpenzim rrjedhës, me përjashtim kur pasuria funksionon si pjesë e një tërësie dhe vlera e tërësisë kalon mbi një mijë (1,000) euro. Në raste të tilla edhe pse vlera e pasurisë është nën një mijë (1,000) euro, kjo pasuri i</p>	<p>months of a year;</p> <p>5.3. A partial depreciation (1/2) can be claimed in respect of assets placed into service in the last six months of a year.</p> <p>5.3.1. If depreciation is fully recognize in the first year of use, the asset is sold or transferred in the first half of the year, no depreciation is recognized in the year of sale or alienation. However, the asset is sold or transferred in the second half, the depreciation in the year of sale or otherwise is recognised only for the first half of the year;</p> <p>5.3.2. If partial depreciation is recognized in the first year of use, and the sale or transfer of asset takes place in the second half, the depreciation in the year of sale or otherwise is recognised only for the first half of the year.</p> <p>6. the purchase of an asset with value of up to one thousand (1,000) euro shall be allowed as an expense, unless the asset functions as part of a whole and the total value exceeds over one thousand (1,000) euro. In such cases, although the value of the asset is under one thousand (1,000)</p>	<p>godine;</p> <p>5.3. Delimična obezvređivanje (1/2) zahteva se u vezi sa imovinom koja je stavljena na upotrebi u drugom polugodištu.</p> <p>5.3.1. Ako se priznaje u potpunosti obezvređivanje u prvoj godini korišćenja, za imovinu koja se prodaje ili prenosi u prvoj polovini godine, ne priznaje se obezvređivanje u godini prodaje ili otuđenja. Međutim, za imovinu koja se prodaje ili otuđuje u drugom polugodištu, onda obezvređivanje u godini prodaje ili otuđenja se priznaje samo za prvo polugodište;</p> <p>5.3.2. Ako je priznato delimično obezvređivanje u prvoj godini korišćenja, i prodaja ili otuđenje imovine nastaje u drugom polugodištu, onda obezvređivanje u godini prodaje ili otuđenja se priznaje samo za prvo polugodište.</p> <p>6. Kupovina jedne imovine sa vrednošću do hiljadu (1,000) evra se dozvoljava kao tekući trošak, sa izuzetkom kada imovina funkcioniše kao deo jedne celine i vrednost celine prekoračuje hiljadu (1,000) evra. U takvim slučajevima iako je vrednost imovine ispod hiljadu (1,000) evra, ta</p>
---	---	---

<p>nënshtrohet procedurës së zhvlerësimit në mënyrë individuale.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 18</b> <b>Zhvlerësimi i aktiveve biologjike</b></p> <p>1. Zhvlerësimi i aktiveve biologjike bëhet sipas nenit 15, paragrafit 3, nënparagrafit 3.2 të Ligjit.</p> <p>2. Zbritja e zhvlerësimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk lejohet për:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Bagëtinë e rritur nga tatimpaguesi - në këtë rast, nuk ka bazë zhvlerësimi meqë kostoja e rritjes së kësaj bagëtie veç është zbritur;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. Bagëtinë e blerë për rishitje - në këtë rast regjistrohen si pjesë e inventarit të tatimpaguesit dhe zbritjet e lejuara si kosto e mallrave të shitura;</p> <p>3. Bagëtinë që nuk është blerë për rishitje me kosto të blerjes prej një mijë (1,000) euro ose më pak, është shpenzim rrjedhës në vitin e blerjes, me përjashtim kur janë pjesë e një tërësie-kope. Në raste të tilla edhe pse vlera e pasurisë është nën një mijë (1,000) euro, i nënshtrohet procedurës së zhvlerësimit në mënyrë individuale.</p> <p>4. Shuma e zhvlerësimit përcaktohet zë për</p>	<p>euro, this asset is subject to the depreciation individually.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 18</b> <b>Depreciation of biological assets</b></p> <p>1. Depreciation of biological assets shall be made under Article 15, paragraph 3, subparagraph 3.2 of the Law.</p> <p>2. Depreciation deduction under paragraph 1 of this Article shall not apply for:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Livestock raised by the taxpayer – in these cases there is no depreciable basis as the cost for raising those livestock will have already been deducted;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. Livestock acquired for resale – in these cases such livestock will be recorded as part of the inventory of the taxpayer and deductions allowed as part cost of goods sold;</p> <p>3. Livestock not acquired for resale which has a purchase cost of 1,000 euro or less – such livestock can be claimed as a current expense in the year of purchase except when they are part of a whole-herd. In such cases, although the value of the asset is under one thousand (1,000) euro, it shall be subject to depreciation individually.</p> <p>4. The amount of depreciation is determined</p>	<p>imovina se podvrgava proceduri obezvređivanja na individualan način.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 18</b> <b>Obezvređivanje bioloških aktiva</b></p> <p>1. Obezvređivanje bioloških aktiva se obavlja na osnovu člana 15, stava 3, podstava 3.2 Zakona.</p> <p>2. Odbitak obezvređivanja na osnovu stava 1 ovog člana, ne dozvoljava se za:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Stoku uzgajanu od Poreskog obveznika - u ovom slučaju, nema osnove za obezvređivanje pošto troškovi uzgajanja ove stoke već je odbijena;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. Kupljenu stoku za preprodaju - u ovom slučaju se registruje kao deo inventara Poreskog obveznika i dozvoljeni odbici kao troškovi prodate robe;</p> <p>3. Stoka koja nije kupljena za preprodaju sa troškovima kupovine od hiljadu (1,000) evra ili manje, je tekući trošak u godini kupovine, sa izuzetkom kada su deo jedne celine – stada. U takvim slučajevima iako vrednost imovine je ispod hiljadu (1,000) evra, podvrgava se proceduri obezvređivanja na individualan način.</p> <p>4. Iznos obezvređivanja se određuje za</p>
--	--	---

<p>zë. Në rastin kur një vlerësim i tillë nuk është praktik, zhvlerësimi bëhet për një grup zërash të ngjashëm, ose që kanë lidhje me njëri-tjetrin.</p>	<p>item by item. In the case where such an assessment is not practical, depreciation is made for group of similar items, or related to one another</p>	<p>svaku stavku. U slučaju kada takvo obezvređivanje nije praktično, obezvređivanje se obavlja za grupu sličnih stavki, ili koja su povezana jedna sa drugom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 19</b> <b>Zbritjet e posaçme për pasuritë e reja</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 19</b> <b>Special deduction for new assets</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 19</b> <b>Posebne povlastice za novu imovinu</b></p>
<p>1. Për pasuritë si: linjat prodhuese për uzina dhe makineri, inventar të hekurudhës dhe lokomotiva që shfrytëzohen për transportin hekurudhor, aeroplanë, anije, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda për qëllim të aktivitetit ekonomik, lejohet zbritje e posaçme prej dhjetë përqind (10%) të vlerës së përvetësimit të pasurisë, në periudhën në të cilën pasuria është vënë për herë të parë në përdorim.</p> <p>2. Zbritja lejohet për pasurinë e re ose për pasurinë e vënë për herë të parë në përdorim në Kosovë. Zbritja nuk lejohet për pasurinë e cila është përdorur nga ndonjë person në Kosovë.</p>	<p>1. For assets such as: Assembly lines for plants and machinery, railway inventory and locomotives used for railway transportation, airplanes, ships, heavy transport vehicles, earth moving equipment, bulldozers, scrapers and other heavy vehicles for purposes of developing an economic activity will benefit from a special deduction of ten per cent (10%) of the value of acquired asset, in the period when the asset was put into use for the first time.</p> <p>2. The deduction shall be allowed for new assets or assets used for the first time in Kosovo. The deduction is not allowed for assets used by any person in Kosovo.</p>	<p>1. Za imovinu kao što su: proizvodne linije za fabrike i mašinerije, inventar železnice i lokomotive koje se koriste za železnički prevoz, avione, brodove, teška transportna sredstva, opreme za prevoz zemljišta, buldožeri, bageri za zemljište i ostala teška sredstva za ciljeve ekonomske aktivnosti, dozvoljava se poseban odbitak od deset procenata (10%) vrednosti prisvajanja imovine, za period u kojem je imovina po prvi put stavljena u upotrebi.</p> <p>2. Odbitak se dozvoljava za novu imovinu ili za imovinu stavljen u prvi put na upotrebi na Kosovu. Odbitak se ne dozvoljava za imovinu koja je korišćena od nekog lica na Kosovu.</p>

<p align="center"><b>Neni 20</b> <b>Riparimi dhe përmirësimi</b></p>	<p align="center"><b>Article 20</b> <b>Repairs and Improvements</b></p>	<p align="center"><b>Član 20</b> <b>Popravka i poboljšanje</b></p>
<p>1. Shuma e shpenzuar për riparim apo përmirësim të asetit kapitalizohet dhe i shtohet vlerës kontabël të asetit, nëse riparimi apo përmirësimi e zgjatë jetën e përdorimit të asetit për së paku një (1) vit, dhe shuma e riparimit apo përmirësimi është më e madhe se një mijë (1.000) euro.</p> <p>1.1. Riparimi apo përmirësimi i cili zgjatë jetën e përdorimit të asetit për një (1) vit ose më shumë, dhe shuma e shpenzuar për riparim apo përmirësim është më e madhe se një mijë (1,000) euro, kostoja e riparimit apo përmirësimit kapitalizohet;</p> <p>1.2. Shpenzimi i ndodhur që nuk plotëson kriterin për t'u trajtuar riparim apo përmirësim, siç mund të jetë shpenzimi i mirëmbajtjes për të mbajtur asetin në gjendje funksionale, pavarësisht që shuma e shpenzuar mund të jetë në vlerën mbi një mijë (1.000) euro, lejohet shpenzim i periudhës.</p> <p>2. Shuma e riparimit apo përmirësimit që plotëson kriterin për kapitalizim, i shtohet vlerës së mbetur kontabël të asetit. Vlera e re kontabël e asetit është bazë për zhvlerësimin e mëtejshëm.</p>	<p>1. The amounts expended for repairs or improvements to an asset shall be capitalized and added to the accounting asset value if the repairs or improvements extend the useful life of the asset for at least one year and the amount of repair or improvement is greater than one thousand (1,000) euro.</p> <p>1.1. Where the repairs or improvements extend the use of the asset by one (1) year or more, and the amount expended on repairs or improvements is greater than one thousand (1,000) euro, the cost of repair or improvement is required to be capitalized;</p> <p>1.2. The expenses incurred which do not meet the criteria to be treated as repair or improvement, such as a maintenance expenses to keep the asset functional, regardless that the amount spent may be over one thousand (1,000) euro, it is allowed as expense for the period.</p> <p>2. The amount of repair or improvement that meets the criteria for capitalization is added to the remaining accounting value of the asset. The new accounting value of the asset is the basis for the further depreciation.</p>	<p>1. Iznos potrošen za popravku ili poboljšanje imovine se kapitalizira i dodaje se računovodstvenoj vrednosti imovine, ukoliko popravka ili poboljšanje produžuje vek trajanja imovine za najmanje jednu (1) godinu, i iznos popravke ili poboljšanja je veća od hiljadu (1.000) evra.</p> <p>1.1. Popravka ili poboljšanje koja produžuje vek upotrebe imovine za jednu (1) godinu ili više, i potrošeni iznos za popravku ili poboljšanje je veća od hiljadu (1.000) evra, troškovi popravke ili poboljšanja se kapitalizuju;</p> <p>1.2. Nastali trošak koji ne ispunjuje kriterij za tretiranje kao popravka ili poboljšanje, kao što može biti trošak održavanja kako bi se imovina održala u radnom stanju, bez obzira što potrošni iznos može biti u vrednosti od iznad hiljadu (1.000) evra, dozvoljava se kao trošak perioda.</p> <p>2. Iznos popravke ili poboljšanja koji ispunjuje kriterij za kapitalizacije, dodaje se preostaloj vrednosti računovodstva imovine. Nova računovodstvena vrednost imovine je osnova za dalje obezvređivanje.</p>

<p>3. Për trajtimin e shpenzimit të riparimit apo përmirësimit, pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet bërë dallimi në mes të shpenzimit që kapitalizohet dhe shpenzimit që në çdo rast trajtohet shpenzim rrjedhës i periudhës. Raste të kësaj natyre mund të jenë: riparimi apo përmirësimi i kulmit, ujësjellësit, suvatimit dhe punë të tjera të ngjashme, konsiderohen riparim apo përmirësim i ndërtesës, por ngjyrosja nuk trajtohet si e tillë; zëvendësimi i motorit ekzistues të automjetit është riparim apo përmirësim, ndërsa ndërrimi i gomave, vajit dhe materialit tjetër harxhues, është shpenzim rrjedhës i periudhës.</p>	<p>3. For the treatment of repair or improvement expenses, despite paragraph 1 of this Article, a difference must be made between expenses capitalized and expenses in each case is treated as current expense of the period. Cases of this nature could be: repair or improvement of the Roof, water supply, plastering and other similar work are considered repairs or improvement of the building, but painting is not treated as such; replacing the existing engine of the vehicle is repair or improvement, while changing tires, oil and other consumable materials, is an expense of the period.</p>	<p>3. Za tretiranje troškova popravke ili poboljšanja, bez obzira na stav 1 ovog člana, treba napraviti razliku između troškova koji se kapitalizuju i troškova koji se u svakom slučaju tretira kao tekući trošak perioda. Slučajevi te prirode mogu biti: popravka ili poboljšanje krova, vodovodnih cevi, malterisanje i ostali slični radovi, smatraju se popravkom ili poboljšanjem zgrade, ali krečenje ne tretira se takvim; zamena postojećeg motora vozila je popravka ili poboljšanje, dok zamena guma, ulja ili ostalog potrošnog materijala je tekući trošak perioda.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 21</b> <b>Shpenzimet kërkimore dhe zhvillimore</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 21</b> <b>Research and Development Expenses</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 21</b> <b>Troškovi istraživanja i razvoja</b></p>
<p>1. Neni 20, paragrafi 1 i Ligjit, përcakton zhvlerësimin e një rezerve natyrore të mineraleve dhe burimeve të tjera natyrore. Shfrytëzuesi i rezervës mund të kërkojë zbritje për shpenzimet e eksplorimit dhe zhvillimit. Shpenzimet për hulumtim, shpenzimet e zhvillimit dhe interesi përkatës, shtohen në llogarinë kapitale, ashtu siç kanë ndodhur. Në fund të periudhës tatimore, pjesa e shpenzimeve të eksplorimit dhe zhvillimit që i përkasin asaj periudhe, përcaktohet duke shumëzuar bilancin në llogarinë kapitale me Koeficientin e Zhvlerësimit (në vijim KZH) i cili është:</p>	<p>1. Paragraph 1 of Article 20 of the Law foresees amortisation of a natural deposit of minerals and other natural resources. The user of the deposit can claim a deduction for the research and development expenses. Research expenses, development costs and related interest must be added to a capital account as they are incurred. At the end of the tax period, the portion of research and development costs belonging to that period shall be determined by multiplying the balance in the capital account by a coefficient of amortization (CA) which is:</p>	<p>1. Član 20, stav 1 Zakona, određuje obezvređivanje nekog prirodnog resursa minerala i drugih prirodnih resursi. Korisnik prirodnih rezervi mogu zahtevati odbitak za troškove istraživanja i razvoja. Troškovi za istraživanje, troškovi razvoja i dotičnog interesa se dodaju računu kapitala, kako budu nastali. Na kraju poreskog perioda, deo troškova istraživanja i razvoja koji pripadaju tom periodu, se određuje umnožavanjem bilansa na računu kapitala sa Koeficijentom Obezvređivanja (u nastavku KO) koji je:</p>



<p>Numri i njësive të nxjerra gjatë vitit KZH =</p>	<p>Number of units extracted during the year CA =</p>	<p>Broj jedinica izvađenih tokom godine KO =</p>
<p>_____ Totali i vlerësuar i njësive në rezerva</p>	<p>_____ Total estimated units in the deposit</p>	<p>_____ Procenjeni total jedinica u rezervama</p>
<p>2. Totali i njësive në rezerva duhet të jetë i vlerësuar nga ekspertët e fushës përkatëse. ATK e ruan të drejtën për të përdorur shërbimet e ekspertëve të pavarur për të vlerësuar njësitë e nxjerra dhe njësitë në rezerva.</p>	<p>2. Total units in deposits should be evaluated by experts in the relevant field. Tax Administration reserves the right to use the services of independent experts to evaluate the units extracted and units in deposits.</p>	<p>2. Total jedinica u rezervama treba da bude procenjen od strane stručnjaka dotičnog područja. PAK sačuva pravo korišćenja usluga nezavisnih stručnjaka za procenu izvađenih jedinica i jedinica u rezervama.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 22</b> <b>Fitimet dhe humbjet kapitale</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 22</b> <b>Capital gains and losses</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 22</b> <b>Kapitalne dobiti i gubici</b></p>
<p>1. Për qëllime të aplikimit të vlerës së hapur të tregut kur shitjet e asetëve kapitale janë bërë në mes personave të lidhur dhe janë më të ulëta se vlera e hapur e tregut, kjo vlerë përcaktohet si:</p>	<p>1. For purposes of applying open market values where sales of capital assets are made between related persons for sales prices that are less than open market value, this value shall be determined as:</p>	<p>1. U svrhe primene otvorene tržišne vrednosti kada prodaja kapitalne imovine je obavljena između povezanih lica i niža su od otvorene tržišne vrednosti, ova vrednost se određuje kao:</p>
<p>1.1. Shuma monetare e parashikuar për një shitje të asetit të njëjtë në mes të blerësit të vullnetshëm dhe shitësit të vullnetshëm në një transaksion të mbizotërimit të tregut;</p>	<p>1.1. The estimated monetary amount for a sale of the same asset between a willing buyer and a willing seller in an arm's-length transaction;</p>	<p>1.1. Monetarni iznos predviđen za prodaju iste imovine između voljnog kupca i voljnog prodavca u transakciji tržišnog nadvladanja;</p>
<p>1.2. Shuma që do të jetë rezultat i shitjes së një asemi të ngjashëm në rrethana të ngjashme (p.sh. cilësi të ngjashme, madhësi të ngjashme ose periudhë kohore dhe kushte të njëjta të shitjes);</p>	<p>1.2. The amount that would arise from the sale of a similar asset in similar circumstances (e.g. similar quality, similar size or time period and similar conditions of sale);</p>	<p>1.2. Iznos koji će biti rezultat prodaje slične imovine u sličnim okolnostima (na primer sličan kvalitet, slična veličina ili vremenski period i isti uslovi prodaje);</p>

<p>1.3. Kur nuk mund të aplikohen nënparagrafët 1.1. dhe 1.2. të këtij neni, aplikohet metoda e miratuar nga ATK, e cila siguron një përafrim të mjaftueshëm objektiv.</p> <p>2. Në rastin kur shitja e asetit kapital bëhet me marrëveshje për pagesë me këste, pagesat të cilat shtrihen në më shumë se një periudhë tatimore, fitimi kapital raportohet në baza lineare gjatë kohës së marrëveshjes me këste.</p> <p>3. Humbja kapitale raportohet në periudhën tatimore në të cilën ka ndodhur transaksioni.</p>	<p>1.3. Where subparagraphs 1.1., and 1.2., of this Article do not apply, a method approved by TAK which provides a sufficiently objective approximation.</p> <p>2. In cases when sale of capital assets involves instalment agreements which span more than one tax period, capital gains shall be reported on a straight-line basis over the duration of the instalment arrangement</p> <p>3. Capital loss reported in the tax period in which the transaction took place.</p>	<p>1.3. Kada se ne mogu primeniti podstavovi 1.1. i 1.2. ovog člana, primenjuje se metoda usvojena od PAK-a, koja obezbeđuje dovoljno objektivno približavanje.</p> <p>2. U slučaju kada prodaja kapitalne imovine se obavlja sporazumom za isplatu na rate, isplate koje se prostiru na više od jednog poreskog perioda, kapitalna dobit se izveštava na linearnoj osnovi tokom trajanja isplate na rate.</p> <p>3. Kapitalni gubitak se izveštava u poreski period u kojoj je nastala transakcija.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 23</b> <b>Shndërrimi jo i vullnetshëm</b></p> <p>1. Shndërrimi jo i vullnetshëm i paraparë në nenin 22 të Ligjit është tjetërsimi i pronës së paluajtshme të biznesit për nevoja publike, përmes procedurës së shpronësimit të realizuar nga autoritetet publike.</p> <p>2. Fitimi kapital nga shndërrimi jo i vullnetshëm i pronës së paluajtshme, nëse konsiderata është marrë nga shndërrimi që përbëhet nga prona e karakterit apo natyrës së njëjtë ose nga paratë që janë investuar në pronën e natyrës apo të karakterit të njëjtë</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 23</b> <b>Involuntary conversion</b></p> <p>1. Involuntary conversion foreseen under Article 22 of the Law is the alienation of immovable property for public business, through expropriation proceedings carried out by public authorities.</p> <p>2. Capital gains from Involuntary conversion of real property, if the consideration is taken from the conversion of the property consisting of the same character or nature or from money invested in property of nature or the same character</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 23</b> <b>Nedobrovoljna konverzija</b></p> <p>1. Nedobrovoljna konverzija predviđen članom 22 Zakona je otuđenje nepokretne imovine biznisa za javne potrebe, kroz procedure eksproprijacije obavljen od strane javnih autoriteta.</p> <p>2. Kapitalna dobit sa nedobrovoljne konverzije nepokretne imovine, ako je razmatranje uzeto od konverzije koja se sastoji od imovine istog karaktera ili prirode ili od novca koji je investiran u imovini istog karaktera ili prirode tokom</p>

<p>brenda periudhës dy vjeçare (2) të zëvendësimit, nuk i nënshtrohet Tatimit në të Ardhurat e Korporatave.</p> <p>3. Periudha dy (2) vjeçare sipas paragrafit 2 të këtij neni është kohëzgjatja prej njëzetekatër (24) muajve nga data e pranimit të konsideratës.</p> <p>4. Në rastin kur tatimpaguesi dështon të zëvendësojë pronën e karakterit të njëjtë brenda afatit të paraparë në paragrafin 3 të këtij neni, njohja e fitimit kapital bëhet në periudhën tatimore në të cilën skadon afati.</p>	<p>within the two (2) year period of replacement, shall not be subject to corporate income tax.</p> <p>3. The period of two (2) years pursuant to paragraph 2 of this article shall be the duration of twenty four (24) months from the date the consideration is taken.</p> <p>4. If a taxpayer fails to replace the property of the same character within the period prescribed in paragraph 3 of this Article, recognition of capital gain shall be made in the tax period in which the term is due.</p>	<p>perioda od dve (2) godine zamene, ne podvrgava se Porezu na Korporacijske Prihode.</p> <p>3. Period od dve (2) godine na osnovu stava 2 ovog člana je trajanje od dvadeset i četiri (24) meseci od datuma primanja razmatranja.</p> <p>4. U slučaju kada poreski obveznik ne uspeva da zamenjuje imovinu istog karaktera unutar roka predviđenog stavom 3 ovog člana, priznavanje kapitalne dobiti se obavlja u poreski period u kojem ističe rok.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 24</b> <b>Humbja Tatimore</b></p> <p>1. Humbja tatimore e krijuar në periudhën tatimore, sipas nenit 23 të Ligjit, bartet dhe thyhet kundrejt të ardhurave në periudhat vijuese të të njëjtit biznes.</p> <p>2. Bartja e humbjes nuk lejohet kur biznesi e ndryshon llojin e tij të organizimit, si:</p> <p>2.1 Nga ndërmarrje personale individuale në entitet juridik;</p> <p>2.2 Ndryshim në pronësi prej më shumë se pesëdhjetë përqind (50%).</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 24</b> <b>Tax losses</b></p> <p>1. Tax losses incurred in one tax period, in line with Article 26 of the Law, shall be carried forward and offset against taxable income in subsequent years of the same business.</p> <p>2. The loss is not allowed to be carried forward when the business changes its type of organization, such as:</p> <p>2.1 From personal individual undertaking into legal entity;</p> <p>2.2 Change in ownership of more than fifty per cent (50%).</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 24</b> <b>Poreski gubitak</b></p> <p>1. Poreski gubitak nastao u poreski period, na osnovu člana 23 Zakona, prenose se i raščlanjuju u odnosu na naredne periode istog biznisa.</p> <p>2. Prenos gubitaka se ne dozvoljava kada biznis menja svoj oblik organiziranja, kao:</p> <p>2.1 Sa individualnog ličnog preduzeća na pravni entitet;</p> <p>2.2 Izmena u vlasništvu za više od pedeset procenata (50%).</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 25 Likuidimi</b></p> <p>1. Personi juridik në rast të likuidimit përcakton fitimin apo humbjen kapitale sikur ta kishte shitur pronën që është shpërndarë gjatë likuidimit sipas vlerës së hapur të tregut.</p> <p>2. Çmimi i blerjes së pronës së shpërndarë në procedurën e likuidimit, për qëllime të përcaktimit të fitimit kapital, është i barabartë me vlerën e tregut të pronës para shpërndarjes së saj.</p> <p>3. Fitimi apo humbja përcaktohet në përputhje me nenin 21 të Ligjit.</p> <p>4. Prona e një dege (njësie, filiali) e cila në një procedurë likuidimi transferohet tek kompania mëmë, nuk përbën fitim apo humbje kapitale për këtë të fundit.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 25 Liquidation</b></p> <p>1. In the event of liquidation, a legal person shall define capital gain or loss presuming that it would have sold the property distributed in the liquidation at its open market value.</p> <p>2. For the purposes of determining the capital gain, the purchase price of the property distributed in the liquidation proceedings shall be equal to the market value of the property before its distribution.</p> <p>3. Gains or losses shall be determined in accordance with Article 21 of the Law.</p> <p>4. The ownership of a branch (unit, subsidiary), which in a liquidation proceeding was transferred to the parent company, does not constitute a capital gain or loss for the latter</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 25 Likvidacija</b></p> <p>1. Pravno lice u slučaju likvidacije određuje kapitalnu dobit ili gubitak kao da je prodao imovinu koja je raspodeljena tokom likvidacije na osnovu otvorene tržišne vrednosti.</p> <p>2. Cena kupovine imovine raspodeljena procedurom likvidacije, u cilju određivanja kapitalne dobiti, jednaka je tržišnoj vrednosti imovine pre njene raspodele.</p> <p>3. Dobit ili gubitak se određuje u skladu sa članom 21 Zakona.</p> <p>4. Imovine jednog ogranka (jedinice, filijale) koja u proceduri likvidacije se prenosi kod matične kompanije, ne sačinjava kapitalnu dobit ili gubitak za potonju.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 26 Riorganizimi</b></p> <p>1. Transferimi i pronës në pajtim me planin e shkruar për riorganizimin e tatimpaguesit qoftë për shkak të bankrotimit, bashkimit, përvetësimit, ndarjes, këmbimit të aksioneve, apo të ndonjë arsyeje tjetër, nuk i nënshtrohet tatimeve sipas Ligjit, nëse për të njëjtën tatimpaguesi ka pranuar miratim</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 26 Reorganisation</b></p> <p>1. Transfers of property pursuant to a written plan for a reorganization of a taxpayer, whether due to bankruptcy, merger, acquisition, sharing, exchange of shares, or otherwise, which is approved by the Tax Administration of Kosovo, shall not be taxed under this Law.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 26 Reorganizacija</b></p> <p>1. Prenos imovine u skladu sa pisanim planom za reorganizaciju Poreskog obveznika bilo zbog bankrotstva, ujedinjenja, prisvajanja, podele, razmene deonica, ili drugog razloga, ne podvrgava se oporezivanju na osnovu Zakona, ukoliko za istu poreski obveznik je dobio odobrenje</p>

<p>nga ATK.</p> <p>2. Tatimpaguesi i cili riorganizohet dhe gjatë këtij procesi ka vazhdimësi me vlerat e pasurive dhe detyrimeve në kontabilitet, riorganizimi nuk ndikon në tatuarje.</p> <p>3. Tatimpaguesi i cili riorganizohet dhe gjatë këtij procesi dhe nuk ka vazhdimësi të vlerës së pasurive dhe detyrimeve në kontabilitet, ndryshimi i kapitalit që rezulton nga ndryshimi i vlerës së pasurive dhe detyrimeve në kontabilitet, riorganizimi ndikon në tatuarje.</p> <p>4. Bashkimi është transaksion me të cilin ndërprejnë aktivitetin, pa procedura të likuidimit, një apo më shumë shoqëri (shoqëri e transferuar), duke i transferuar të gjitha pasuritë dhe detyrimet tek shoqëria e re (shoqëria përvetësuese), në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Kosovë.</p> <p>5. Përvetësimi është transaksion me të cilin pushojnë së ekzistuari, pa procedura të likuidimit, një apo më shumë shoqëri (shoqëria e transferuar), duke i transferuar të gjitha pasuritë dhe detyrimet tek një shoqëri tjetër ekzistuese (shoqëria përvetësuese), në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Kosovë.</p> <p>6. Ndarja është transaksion që përfshin</p>	<p>2. When a taxpayer is being reorganised and meanwhile continues to keep the book value of assets and liabilities values, the reorganisation does have an impact on the taxation.</p> <p>3. When a taxpayer is being reorganised and meanwhile does not continue to account for assets and liabilities values, the difference of the capital resulting from the difference of the book value of assets and liabilities, the reorganisation has an impact on the taxation.</p> <p>4. The merge is a transaction in which one or more companies cease the activity without liquidation proceedings (transferred company), by transferring all assets and liabilities to the new company (acquiring company), in accordance with the Law on Trade Associations in Kosovo.</p> <p>5. Acquisition is a transaction in which one or more companies cease their existence without liquidation proceedings (transferred company), by transferring all assets and liabilities to another existing company (acquiring company), in accordance with the Law on Trade Associations in Kosovo.</p> <p>6. The division is transaction involving the</p>	<p>od strane PAK-a.</p> <p>2. Poreski obveznik koji se reorganizuje i tokom ovog procesa ima kontinuiteta vrednosti imovine i obaveza u računovodstvu, reorganizacija ne utiče u oporezivanje.</p> <p>3. Poreski obveznik koji se reorganizuje i tokom ovog procesa nema kontinuiteta vrednosti imovine i obaveza u računovodstvu, izmena kapitala koji rezultira sa izmene vrednosti imovine i obaveza u računovodstvu, reorganizacija utiče na oporezivanje.</p> <p>4. Ujedinjenje je transakcija kojom prestaju sa aktivnostima, bez procedura likvidacije, jedna ili više društva (transferisano društvo), transformisanjem (prenosom) imovine i obaveza kod novog društva (društvo prisvajanja), u skladu sa Zakonom o Trgovinskim Društvima na Kosovu.</p> <p>5. Prisvajanje je transakcija kojom prestaju sa postojanjem, bez procedura likvidacije, jedno ili više društva (transferisano društvo), transformisanjem celokupne imovine i obaveza kod drugog postojećeg društva (društvo prisvajanja), u skladu sa Zakonom o Trgovinskim Društvima na Kosovu.</p> <p>6. Podela je transakcija koja uključuje</p>
--	---	---

